

VENDIM
Nr. 13, datë 30.4.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 5, DATË 22.2.2023, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË SHA”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 30.4.2025, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 5, datë 22.2.2023, ‘Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. 5662 prot., datë 15.4.2025, me lëndë: “Njoftim për ndryshimin e drejtuesit ligjor të Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit të ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë me vendimin nr. 5, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimin e ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë, z. Skerdi Drenova, ka përfunduar studimet e larta në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari do të veprojë në përputhje me kushtet e licencës dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, efektivitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 2(a)të vendimit të KKRR-së nr. 5, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjetës-Kanalizime Tiranë sh.a.”, ndryshon si më poshtë:

“Drejtues ligjor: z. Skerdi Drenova.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gerta Lubonja